



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL-Anr.128/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kandidatit (Shkëlqim Sylejmani), me seli në Pejë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ZL-Anr.128/2025 e datës 07.10.2025.

II. Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00, (pesëqind) Euro.

III. Detyrohet Subjekti Politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ti largojë posteret e vendosur në dy lokacione, dhe atë në rrugën “Zija Basha”, lagjja Rrokaqielli; dhe në rrugën “Ymer Prizreni”, lagjja Fidanishtë – Pejë, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Ar sy e t i m

Me datë 07.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ku pretendojnë se më datë 06.10.2025, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kishin vënë re vendosjen e posterëve zgjedhor nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kandidati (Shkëlqim Sylejmani) për Kuvendin Komunal, në shtylla elektrike, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregulloret zgjedhore që ndalojnë përdorimin e hapësirave të tilla për material zgjedhor. Vendosja ishte bërë në dy lokacione, në rrugën Zija Basha”, lagjja Rrokaqielli; dhe në rrugën “Ymer Prizreni”, lagjja Fidanishtë – Pejë.

Ky veprim është në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, i cili ndalon ekspozimin e materialeve të fushatës në hapësirat dhe objektet publike, përfshirë shtyllat elektrike. Me tutje theksojnë se vendosja e materialeve në infrastrukturën publike pa autorizim, përbën shkelje të dispozitave të fushatës dhe cenon parimin e barazisë së subjekteve politike në procesin zgjedhor. Kjo praktikë bie ndesh me nenin 36 të Ligjit Nr.08/L-228, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, që ndalon përdorimin e pasurisë publike për qëllime elektorale.

Me tutje në ankesë kërkohet nga PZAP që të konstatojë shkeljen e bërë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore, duke përfshirë urdhrin për largimin e menjëhershëm të materialeve të vendosura në mënyrë të kundërligjshme dhe shqiptimin e sanksioneve administrative.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografitë që dëshmojnë vendosjen e banereve/posterëve në kundërshtim me rregulloren zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) theksojnë se me asnjë provë konkrete nuk është vërtetuar se posterët e përmendur janë vendosur në rrugët e lartëcekura, nga kandidati i AAK-së apo nga persona të lidhur me subjektin politik AAK. Për më tepër, është e pabazuar dhe spekulative të pretendohet se këto materiale janë vendosur nga ana e AAK-së, ngase nuk përjashtohet mundësia që vetë ankuesi apo persona të tjerë, për motive politike, mund t'i kenë vendosur këto postera me qëllim të dëmtimit të imazhit të subjektit politik dhe kandidatit, Shkëlqim Sylejmani. Për më tepër, dispozita e nenit 117 par.3 të LZP-së ka përcaktuar në mënyrë të qartë se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Në mungesë të provave të qarta dhe të besueshme, një pretendim i tillë i ankueses mbetet thjesht një supozim pa bazë faktike apo juridike, i cili nuk mund të ngarkohet si përgjegjësi ndaj subjektit politik AAK, Shto këtu faktin, se në ankesën e paraqitur janë përmendur vetëm rrugët ku pretendohet se është kryer shkelja, mirëpo nuk është përmendur ndonjë rrethanë konkrete që do të mund të shërbente si bazë për verifikimin e saktë të vendit të ngjarjes.

Andaj, bazuar në të lartëcekurat, rezulton se të gjitha pretendimet e ankueses lidhur me shkeljen e nenit 7 par.2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, dhe nenit 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme janë tërësisht të pabazuara në prova dhe fakte konkrete.

Për më tepër nga provat e bashkangjitura me këtë ankesë, në asnjë mënyrë nuk mund të vëretohet saktë se kur janë vendosur këto posterë, pasi që afati për paraqitjen e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, e që në rastin konkret kjo shkelje e pretenduar mund të ketë ndodhur edhe më herët.

Në ndërlidhje me çështjen e afatshmërisë, subjekti politik AAK, thekson se me dispozitën ligjore të Nenit 39, par. 3 të LZP-së, përcaktohet se: *"3 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, Ose të drejtat e të cilitjanë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve nga koha e pranimi të saj."*

Andaj, në aplikim të drejtë të dispozitës së lartpërmendur dhe duke marrë parasysh se barrën e provës lidhur me çështjen e afatshmërisë së ankesës, e ka vetë ankuesi, konkludojnë se ankesa, në këto rrethana konsiderohet e pasafatshme.

Kjo për faktin se materialet zgjedhore janë vendosur që nga fillimi i fushatës më datë 12.09.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor prej 48 orësh nga momenti i pretenduar i shkeljes. Për më tepër ankuesi nuk ka specifikuar datën, orën, e as rrethanat të tjera se kur pretendohet të jenë vendosur posterët në fjalë, çka e bën ankesën e saj të paqartë dhe të pambështetur faktikisht.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka vendosur banerë/poster në shtyllë elektrike, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që*

shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Tutje, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publike, gjegjësisht në rrugën “Zija Basha”, lagjja Rrokaqielli; dhe në rrugën “Ymer Prizreni”, lagjja Fidanishtë – Pejë përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjtat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Paneli konstatoi se nuk qëndron pretendimi i subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) se “është e pabazuar dhe spekulative të pretendohet se këto materiale janë vendosur nga ana e AAK-së, ngase nuk përjashtohet mundësia që vetë ankuesi apo persona të tjerë, për motive politike, mund t'i kenë vendosur këto postera me qëllim të dëmtimit të imazhit të subjektit politik dhe kandidatit, Shkëlqim Sylejmani, ngase në përgjigjen e dhënë nga ky subjekt politik është konfirmuar se i kanë vendosur posterat duke potencuar se ... materialet zgjedhore janë vendosur që nga fillimi i fushatës më datë 12.09.2025, pra e pohojnë se janë vendosur posterat nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Po ashtu nuk qëndron pretendimi se ankuesi nuk e ka potencuar datën e shkeljes së pretenduar pasi që në ankesë është potencuar data 06.10.2025 ndërsa ankesa është parashtruar me datën 07.10.2025 pra brenda afatit ligjor prej 48 orësh.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), përkatësisht kandidati për assemble komunale ka shfrytëzuar hapësirat publike gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimi i këtij kandidati bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik AAK ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati Shkëlqim Sylejmani, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterat e vendosur në rrugën “Zija Basha”, lagjja Rrokaqielli; dhe në rrugën “Ymer Prizreni”, lagjja Fidanishtë – Pejë, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuara më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL-Anr.128/2025 datë 10.10.2025.

Kryesues i Panelit
Skender Coci



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.